



KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT

Tabela paraprake e vlerësimit të fakteve/vlerësimit nga monitorimi		Datë: 04/03/2019	Numri i seancës për këtë çështje:
Ky monitorim u realizua në kuadër të projektit nr.2 "Për të rritur transparencën, gjithëpërfshirjen dhe përgjegjshmërinë në procesin e Vettingut"- projekt i mbështetur financiarisht nga Fondacioni për Shoqërinë e Hapur Shqipëri (OSFA) dhe zbatuar nga Komiteti Shqiptar i Helsinkit (KSHH).			
A. Informacioni bazë			
Institucioni dhe tema:	Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, seanca dëgjimore e subjektit të rivlerësimit		
Emri i subjektit të rivlerësimit	Marsida Xhaferllari		
Pozicioni i punës/ qyteti nëse nuk është Tirana	Kryeinspektore, KLD		
A u shty seanca dhe a ishte e arsyeshme kjo shtyrje?	Seanca dëgjimore zgjati afro dy orë. Në përfundim të shpjegimeve dhe konkluzioneve nga subjekti, trupi gjyqës vendosi ta shtyjë seancën.		
A u shpall vendimi apo jo (Ju lutem paraqisni arsyet në mënyrë të përmbledhur)	Vendimi nuk u shpall në fund të seancës dëgjimore, pasi trupi gjyqës caktoi datën 11 mars, për shpalljen e tij.		
B. Aktorët që marrin pjesë në proces/seanca			
Trupa gjyqëse (emrat)	Firdes Shuli(kryetare); Roland Ilia(relator); Xhensila Pine(anëtare)		
Monitoruesit ndërkombëtarë (emrat)	Hans Kijlstra		
Mbrojtje me avokat apo mbrojtje personalisht (specifikoni)	Mbrojtja u krye personalisht nga subjekti		
Monitoruesi/ja i/e KSHH:	Dafina Zeneli		
Anëtarë të tjerë të publikut të pranishëm?	Të pranishëm gjatë seancës dëgjimore, ishin rreth 20 persona.		
Media e pranishme:	Seanca u ndoq edhe nga disa përfaqësues të medias, kryesisht nga televizionet informative si dhe nga media të shkruara. Në zbatim të nenit 3 të Rregullores "Për marrëdhëniet me median", operatorët dolën së bashku me mjetet e xhirimit pas hapjes.		
C. A vendosi institucioni i vettingut ta bëjë vettingun për të tre kriteret apo bazuar vetëm në një apo dy prej tyre?	Po	Nëse po, si u justifikua ai?	Nëse po, si ka reaguar subjekti ndaj kësaj ?
	Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, vendosi të kryejë vlerësimin për të treja kriteret: pasuror, moral dhe profesional.		

D. Përmbajtja e çështjes (Vlerësimi i kritereve)	Argumenti	kush e ka dhënë argumentin	A u diskutua? Prova? A u kalua barra e provës ?
D1. Pasuria	Në përfundim të veprimeve verifikuese të kryera lidhur me subjektin e rivlerësimit, rezultojnë se: 1) deklarimi është i saktë dhe në përputhje me ligjin; 2) ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë; 3) nuk ka kryer fshehje të pasurisë; 4) nuk ka kryer deklarim të rremë; 5) nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesit.	ILDKPKI	Subjekti falënderoi për gjetjet dhe vlerësimin KPK për dy kriteret, atë pasuror dhe moral. "Asnjë pozicion zyrtar, nuk e pashë si privilegj, por si përgjegjësi"
	Pasuria e subjektit 25 milionë lekë të ardhurat në periudhën deklaruese 4.2 milionë lekë në dhjetor 2017. Pasuria përbëhet nga likuiditete të depozituara në bankë. 66 % e të ardhurave vijnë nga paga për shkak të funksionit, rreth 28.5 % nga angazhimi në projekte të shoqërisë civile, pjesa tjetër të ardhura nga mësimdhënia.	ILDKPKI	
	"Kemi kryer hetim të thelluar në lidhje me disa llogari bankare në emër të Marsida Xhaferllarit në disa banka. Gjatë hetimit janë kryer të gjitha verifikimet dhe ka rezultuar se nuk ka pasuri të fshehura. Nga analiza financiare ka rezultuar se Marsida Xhaferllari nuk ka pasuri të pajustificuara"	Relatori i çështjes	
D2. Figura /Kontaktet me krimin e organizuar	Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar pasi ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit, me anë të verifikimit të deklarimeve dhe të dhënave të tjera, ka arritur në përfundimin se subjekti i rivlerësimit nuk ka kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, duke konfirmuar përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës së subjektit të rivlerësimit	DSIK	
	Nga hetimi administrativ nuk u gjet asnjë element që të vërtetojë ekzistencën e kontakteve të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës dhe ligjin nr. 84/2016. Për subjektin e rivlerësimit konstatohet se është në kushtet e përshtatshmërisë për vazhdimin e detyrës.	KPK	
	Kriteri profesional mori pjesën kyesore të seancës dëgjimore të subjektit. Relatori theksoi se është e paqartë, nëse subjekti Xhaferllari ka statusin e magjistrates, apo të nëpunësit civil, duke i përforcuar dyshimet me pjesëmarrjen në një konkurs të Shërbimit Civil nga ana e subjektit. Po ashtu, KPK ngriti dyshime mbi një konflikt të mundshëm interesi, pasi vlerësimi profesional i subjektit si kryeinspektore e KLD-së, është bërë pikërisht nga ky institucion, madje nga vartësit e saj. Relatori theksoi se Operacioni Ndërkombëtar i Monitorimit ka paraqitur një raport, duke ngritur disa çështje sa i përket kriterit profesional të subjektit. -Vlerësimet nga Inspektoriati i KLD-së për subjektet e rivlerësimit, kanë qenë thuajse të gjitha pozitive, duke mos evidentuar të metat, ç'ka sipas relatorit lë vend për dyshime. -Gjatë vlerësimit mbi aftësitë profesionale të gjykatësve para se të rivlerësoheshin në KPK, në disa raste rezultojnë se janë përdorur "standarde kontradiktore". Në analizën e kryer, kohëzgjatja e gjyqimit në tejkallim të afateve, ishte vlerësuar nga Inspektoriati në disa raste problematik, në të tjera si afat i arsyeshëm. -Ka pasur dy denoncime nga publiku për vonesa në shqyrtimin e ankimit. -KPK evidentoi dhe kërkoi shpjegime se përse nuk kanë nisur procedime disiplinore nga Inspektoriati i KLD-së, ndaj anëtarëve të Gjykatës së Lartë.	KPK	

<p>D3. Vlerësimi i aftësive profesionale dhe etikës</p>	<ul style="list-style-type: none"> • Subjekti u shpreh se Inspektoriati i KLD-së ka kryer vlerësimin profesional të 111 gjyqtarëve. Deri tani sipas saj nuk është bërë asnjë vërejtje apo sugjerim nga ana e KPK-së. Ndërkohë nënvizoi se u ka kërkuar përfaqësuesve të ONM-së t'i bëjnë me dije problemet dhe i vetmi sugjerim i tyre, ka të bëjë me raportet për gjyqtarët që vëzhguesit i kanë cilësuar shumë të gjata. • Sa i përket statusit të saj si magjistrate apo nëpunëse civile, Xhaferllari u shpreh se edhe pse ka shërbyer në pozicione të tjera, gëzon statusin e magistrates, madje solli në vëmendje se bënte pjesë në grupin e parë të magistratëve të diplomuar në Shqipëri. Ajo shpjegoi se kur ka lënë punën si gjyqtare për të punuar në Ministrinë e Drejtësisë, kalimi është bërë bazuar në ligj, sipas të cilit gjyqtarët mund të shërbenin në strukturat e Ministrisë së Drejtësisë pa afat. • Xhaferllari shpjegoi edhe situatën e dyshuar, të konfliktit të interesit. Me mbërritjen e listës prioritare të rivlerësimit, ku ishte përfshirë edhe emri i saj, Xhaferllari shpjegoi se ka vënë në dijeni si Ministrin ashtu edhe Institucionin e Presidentit. Pas sugjerimit që çështjen ta zgjidhë grupi i punës, ky i fundit ka marrë vendim se vlerësimi profesional i saj do të bëhej nga inspektori më i vjetër në detyrë. • Subjekti kundërshtoi pretendimin se raportet e Inspektoriatit ishin pozitive, duke lexuar disa cilësime në vendimet e KPK-së, ku gjyqtarët vlerësoheshin negativisht apo mjaftueshëm. Subjekti u shpreh se nga 12 gjyqtarë të hetuar edhe në aspektin profesional, 4 ishin shkarkuar bazuar në këto raporte dhe se kjo ishte një shifër jo e vogël. • Lidhur me denoncimet për moshqyrtim në kohë të ankesave, Xhaferllari kërkoi ndjesë për vonesat ndaj zonjës denoncuese si dhe çdo qytetari që ka bërë ankim, por u shpreh se fluksi i tyre dhe volumi i punës ishte i madh, krahasimisht me burimet njerëzore në Inspektoriat. • Sa i përket argumentit të KPK-së se në fazën tranzitore, Inspektoriati i KLD-së, duhet të bënte hetim disiplinor ndaj anëtarëve të Gjykatës së Lartë, subjekti nënvizoi se nuk ka një parashikim të tillë ligjor. Madje shtoi se si kryeinspektorja ashtu edhe inspektorët kanë statusin e gjyqtarit të apelit, ndaj rrjedhimisht nuk mund të hetojnë ata që janë me status më të lartë. 	<p>Subjekti i rivlerësimit</p>	<p>Subjektit iu kalua barra e provës.</p>
<p>E. Konkluzione dhe komente të monitoruesit të KSHH (Vlerësimi paraprak i monitoruesit të KSHH për aspektet e procesit të drejtë ligjor (publiciteti, etika e organeve të vettingut dhe përfaqësuesit të OMN , si e vlerësoni hetimin administrativ, të drejtat e mbrojtjes së subjektit, barazia e mjeteve ligjore, parimi i kontradiktoritetit, koha e arsyeshme, e drejta për të paraqitur prova dhe e drejta për tu dëgjuar, etj.)</p>	<p>Në vetëm pak minuta nga nisja e seancës, relatori theksoi se nga raportet e institucioneve ndihmëse por edhe hetimi i thelluar administrativ i KPK-së, rezultoi se subjekti i justifikon pasuritë dhe se është në përshtatshmëri për vijimin e detyrës. Ndërkohë kriteri profesional mori pjesën kyesore të seancës dëgjimore. Relatori vuri në pikëpyetje statusin e subjektit, duke iu referuar edhe një raportit të vëzhguesit të ONM-së. Por subjekti Xhaferllari që në nisje theksoi se vlerësimi i saj ka zgjatur shumë, pasi ka pritur të jetë ndër të parët për shkak të kandidaturës së saj për postin e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë. Ajo u shpreh, se nuk do të mbrohej me procedurë, por deklaroi se për shkak të interesit publik do të vinte në dukje, ato që i konsideroi si probleme procedurale. Teksa kundërshtoi gjetjet e KPK-së, tha se këto pikëpyetje mund të çojnë në konflikt kompetencash të institucioneve të reja të drejtësisë. Sa i përket raportit të monitoruesit, subjekti e cilësoi si mendim, pa përmbajtje konkluduese. Më tej theksoi se vëzhguesi i huaj, nuk është në pozitë të mirë për të interpretuar ligjin shqiptar, duke renditur si arsye mosnjohjen e gjuhës dhe kontekstin historik. Madje për ta mbështetur argumentin e saj, solli në vëmendje parimin e Subsidiaritetit dhe qëndrimin e GJEDNJ-së në raste të ngjashme.</p> <p>Seanca dëgjimore, u zhvillua në respektim të parimit për një procesi të rregullt ligjor. Megjithatë, ngrihen pikëpyetje mbi fazën përgatitore, që edhe nga vetë subjekti u evidentua si proces i vonuar, pasi Xhaferllari ishte në listën prioritare. Në lidhje me parimin e publicitetit të gjykimit, rezultoi se: data, vendi, dhe ora e zhvillimit të seancës dëgjimore u njoftuan paraprakisht, në faqen zyrtare të KPK-së. Seanca ishte e hapur për të interesuarit, që mund ta ndiqnin atë pas shënimit të gjeneraliteteve në hyrje të sallës. Mediave po ashtu, u ishte krijuar hapësira e nevojshme, për ndjekjen e seancës sipas rregullores së miratuar.</p>		